

Dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e kontratave të reja individuale për furnizimin me ujë

Për të lehtësuar procesin e aplikimit dhe për të garantuar transparencë në shërbim, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a. informon qytetarët mbi dokumentacionin që duhet të dorëzohet për lidhjen e kontratave të reja individuale të furnizimit me ujë. Aplikimi bëhet pranë zyrave të Kujdesit Ndaj Klientit në Njësitë Zonale/Drejtoritë Rajonale me dokumentacionin si më poshtë:

1. Dokument identifikimi (Kartë ID ose Pashaportë).
2. Çertifikatë Familjare .
3. Dokumenti i Pronësisë përfshin 1(një) nga dokumentet e mëposhtëm:
 - Çertifikatë Pronësie e shoqëruar me kartelë dhe hartë treguese të lëshuar nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ASHK). *Certifikatës pronësisë ti bashkëlidhet dokumentacioni i origjinës pronës me qëllim verifikimin e ish pronarit nëse objekti ka kontratë egzistuese me UKT-sh.a.*
 - Vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) që objekti është në proces Legalizimi.
Kontrata të nënshkruar me palët në prani të noterit, si më poshtë.
 - Kontratë shit-blerje.
 - Kontratë porositje.
 - Kontratë për Klering.
 - Kontratë shkëmbimi.
 - Kontratë dhurimi.
 - Kontratë e lidhur me subjektin ndërtues dhe pronarët e truallit ku është ndërtuar objekti.
Kontratat e lartëpërmendura të shoqërohen me proces-verbalin e marrjes në dorëzim të ambijentit të nënshkruar nga palët në prani të noterit. (Në rast se do të kërkohet nga UKT-sh.a).
 - Dëshmi trashëgimie e shoqëruar me dokumentin e pronësisë në emër të trashëgimlënësit dhe certifikatë vdekje.
 - Vendim Gjykatë i formës prerë.
 - Kontratë Qera-Marrje e shoqëruar me një nga dokumentat e pronësisë si më lart.
4. Për rastet kur në një nga dokumentat e lartëpërmendura janë disa bashkëpronar duhet të dorëzohen fotokopjet e kartave të identitetit ose pashaportave të bashkëpronarëve ku të jenë të nënshkurara me shkrim që janë dakort që kontrata e furnizimit me ujë të lidhet në emrin e bashkëpronarit i cili aplikon për lidhjen e kontratës re.
5. Vendime të Ekzekutivit (për rastet e institucioneve Buxhetore).
6. Foto objekti

7.Ekstrakt nga QKB ose liçencë (Në rast se aplikuesi është subjekt privat).

8.Libreze Pensioni/Vertetim invaliditeti (Në rastet kur aplikanti është përfitues në bazë të Vendimit nr.18, dt.12.01.2018 për subvencionimin e lidhjes kontratave dhe vendosjes së matësive të ujit për kategorinë në nevojë).

9.Deklaratë Personale (plotësohet në momentin e aplikimit pranë zyrave të UKT-sh.a)

Çmimet për lidhjen e kontratave varen nga mënyra e pajisjes me matës:

Rasti kur matësi blihet pranë UKT (me rakorderi):

Familjare dhe privat					
Nr.	Dimension	Vlera e kolaudit	Vlera e matësit me rakordim	Vlera e kontratës	Shuma totale
1	1/2"		4.930	3000	7.930
2	3/4"		5.720	3000	8.720
3	1"		7.494	3000	10.494

Rasti kur matësi blihet pa rakorderi pranë UKT:

Familjare dhe privat					
Nr.	Dimension	Vlera e kolaudit	Vlera e matësit pa rakordim	Vlera e kontratës	Shuma totale
1	1/2"		3286.6	3000	6286.6
2	3/4"		3614.6	3000	6614.6
3	1"		4887.6	3000	7887.6

Rasti kur matësi është blerë nga abonenti dhe vendoset nga UKT:

Familjare dhe privat				
Nr.	Dimension	Vlerë vendosje dhe vulosje matësi	Vlera e kontratës	Shuma totale
1	1/2"	628	3000	3628
2	3/4"	715	3000	3715
3	1"	804	3000	3804